

Emri i Lëndës : Psikologjia e Fesë							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 324	A	Pranverë	2.00	0.00	0.00	2.00	3.00
Lektori	Skënder Brucaj, PhD						
Asistenti							
Gjuha e kursit	Shqip, Anglisht, Turqisht						
Niveli i lëndës	Bachelor						
Përshkrimi	Feja është një nga forcat më dinamike që ndikon botëkuptimin e njerëzve në lidhje me jetën,kulturën dhe ndërveprimet sociale. Në këtë lëndë do të prezantohen termat dhe problematikat e lidhshmërinë mes fesë dhe psikologjisë, duke shqyrtuar zhvillimin historik, vështirësitë e hasura në hulumtim si dhe fushat kërkimore të saj. Një fokusim i veçantë do të jetë mbi tematikat dhe përvojat fetare që mund të përshkruhen dhe kuptohen nga perspektivat e shkences së psikologjisë.						
Objektivat	1.Pajisja e studentit me njohuri rreth temave, problematikave themelore, historikut dhe fushave të kërkimit në psikologjinë e fesë. 2. Paraqitja e një përmbledhje të mënyrës se si psikologët studiojnë fenë dhe temat përkatëse përmes leksioneve, diskutimeve dhe projekteve të caktuara. 3.Studentët do të zbulojnë se si psikologjia na ndihmon të kuptojmë sjelljen dhe përvojën fetare. 4. Paraqitja dhe analizimi i elementeve psikologjike të jetës fetare. 5.Të mësuarit rreth disa mënyrave në të cilat religjoni dhe praktikat fetare ndikojnë në funksionimin psikologjik dhe mënyrat në të cilat funksionimi psikologjik ndikon në besimet dhe praktikat fetare.						
Konceptet Kryesore	Feja , Psikologjia e Fesë ,Personaliteti , Pervoja fetare , Identiteti Fetar , Spiritualiteti.						
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Një hyrje e shkurtër në psikologjinë e fesë dhe historikut të saj . Përkufizimi, përmbajtja dhe qëllimi i psikologjisë së fesë . Marrëdhënia e psikologjisë së fesë me shkencat e tjera. Diferencimi midis shprehjes devocionale dhe studimit të fesë. Paloutzian (2017) , invitation to the psychology of religion.Ch1 p.29-60						
2	Përshkrimi i fesë nga perspektiva e psikologëve klasikë dhe modern duke bërë dallime midis qasjeve të psikologëve të ndryshëm siç janë Ibn Sina, Gazali, James, Adler , Maslow, Freud , Jung ,Vicktor Frynkle , Hasan Tahsini dhe Malik Badr Paloutzian (2017) , Intellectual Journey to the Psychology of Religion.Ch2 p.60-95						
3	Teoritë e personalitetit dhe të egos , zhvillimi i përkatësisë fetare bazuar në ndërveprimet personale . Përshtatja i individit me normat sociale Paloutzian (2017) , Psychological theories Look at Religion.Ch2 p.60-95						
4	Qëndrimet ,paragjykimet dhe diskriminimi ,ndikimi i gjuhes së urrejtjes dhe intolerances në kohezionin social . Faktorët që ndikojne në forcimin e identitetit fetarë. C. Rowatt (2014) Religion, Prejudice, and Intergroup Relations Chp 8 p.170-190						
5	Ndjenjat fetare , aspektet psikologjike të adhurimit- pendimi dhe shqyrtimi i tij psikologjik , ndikimi i fesë në zhvillimi kognitiv,emocional dhe social të individeve Pehr Granqvist (2014) Religion and Cognitive, Emotional, and Social Development Chp.13 p.280-300.						
6	Marrëdhënia midis fesë dhe individit , vetja dhe kultura , individi dhe grupi . Personaliteti fetar midis vetes së pavarur dhe asaj të ndërvuar. Marrëdhëniet ndërmjet individëve dhe grupeve fetare Paloutzian (2017) Looking for Religion in the Individual Ch 8 p 210-239						

7	Përvoja fetare dhe dallimet midis përvojave mistike dhe spiritualitetit . Lidhja midis devoshmerisë fetare dhe spiritualitetit. Diskutime mbi besimin, ritualet dhe përvoja shpirtërore si elementet kryesorë të fesë. Paloutzian (2017) Religion, spirituality, and experience Chp.9 p.270-300
8	Provimi gjysmë final
9	Feja gjatë zhvillimit personal, zhvillimi fetar dhe shpirtëror në fëmijëri ,adoleshencë dhe pleqëri,feja dhe dallimet gjinore . Paloutzian (2017) developmental processes in religiousness and spirituality Chp.5 p.171-210
10	Religjoni dhe morali , identifikimi i vlerave universale në raport me diversitetin fetar, a na bën feja një person më të mirë? Michael Argyle (2005) Religious and other origins of morals p.141-153
11	Feja, shëndeti mendor dhe mirëqenia sociale ,psikoterapia dhe përkujdesi shpirtëror, Paloutzian (2017) Religion, Mental Health, and Well-Being p.300 -330.
12	Psikologjia pozitive , psikologjia pastorale , fuqia e mendimit positive , logoterapia. Paloutzian (2017) Religion and Health-Related Issues p.330-350
13	Feja dhe ndikimi i saj në formësimin e identitetit nacional , etnocentrizmi dhe identiteti fetar .Transmetimi i kultures fetare tek brezat e rinjë si pjesë e subkoshijes sociale të shoqërisë . Kathryn A. Johnson (2017) Religious and National Cultures p.349-370
14	Radikalizmi fetar , ekstremizmi i dhunshëm dhe personaliteti i terroristit , roli i ideologjisë dhe fesë në kalimin nga konflikti në radikalizim dhe terrorizëm Koomen (2016) Social Identity, ideology and religion p.157-185
15	Prezantim i projekteve nga studentët
16	Provimi Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Invitation to the psychology of religion , Raymond F. Paloutzian , The Guilford Press, NY 2017 • The Psychology of Religion : An Empirical Approach , Ralph W. Hood, THE GUILFORD PRESS ,NY 2018	
Referenca të tjera	
•	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Pajisja e studentëve me informacione në lidhje me çështjet e psikologjisë së fesë si dhe aftësi për ta përdorur dhe vlerësuar informacionin e ri
2	Studentet njihen me vlerat shpirtërore dhe morale dhe rolin e tyre unifikues dhe integruues në shoqërisë.
3	Studentët do të demonstrojnë një kuptim kritik të implikimeve dhe zhvillimeve historike në praktikën e fesë dhe interpretimin psikologjik të fesë.
4	Studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike dhe të analizojë një larmi të fenomeneve fetare nga një qasje psikologjike.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			78
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			3.12
ECTS			3.00